

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vdekja e Mazonakis hap "kutinë e pandorës", kimioterapi pa licencë në klinikën e Selanikut, hetimet zbulojnë problematikat në spital
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/28/vdekja-e-mazonakis-hap-kutine-e-pandores-kimioterapi-pa-licence-ne-kliniken-e-selanikut-hetimet-zbulojne-problematikat-ne-spital0/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 19:03:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 18:41:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 18:40:00 UTC → 28 shtator 2026, 18:42:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f96eab5f3348de597abb7f587b705b56f296db8c52324d76a6b8f3624a210bb3
TEKSTI	e1225599cafb7d8cbc909389d3be3b11a86a6f922dc1ee7ec7cb794a3e0ef062
PAMJA	7008c43c77a7d141aa0cb7d3231d868ff887d82d2d92e32d3beff6f1ddc52e3a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a8f9c2f8970d091b734e3636be06c1f74082b5fe57304e696c12a175a1d0f7b3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a8f9c2f8970d091b734e3636be06c1f74082b5fe57304e696c12a175a1d0f7b3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

Vdekja e Mazonakis hap “kutinë e pandorës”, kimioterapi pa licencë në klinikën e Selanikut, hetimet zbulojnë problematikat në spital

28/09/2026 20:41



Menjëherë pas vdekjes së këngëtarit të njohur grek Giorgos Mazonakis, kontrolle të shumta kanë nisur në Greqi në klinika dhe qendra të ndryshme private. Dhe mbremjen e së hënës, në Selanik, autoritetet vendosën mbylljen e një klinike private, ku u zbulua se funksiononte ilegalisht një repart onkologjik dhe kryheshin kimioterapi pa licencën përkatëse.

Kontrolli i Autoritetit Kombëtar të Transparencës tregoi se klinika kishte ngritur një repart të plotë onkologjik, me pajisje edhe për përgatitjen e barnave kimioterapeutike, megjithëse ky repart nuk përfshihej fare në licencën e saj.

Sipas hetimit, aty punonte një pneumolog i specializuar në onkologjinë e mushkërive, por pa kontratë të shkruar me klinikën. Që nga viti 2022, ai përshkruante barna kimioterapie për pacientët dhe më pas trajtimet kryheshin brenda repartit të paautorizuar.

Autoritetet konstatuan gjithashtu se klinika nuk kishte numrin e nevojshëm të infermierëve, i mungonin mjekë të disa specialiteteve të detyrueshme dhe nuk kishte në funksion as Njësinë e Kujdesit Intensiv, megjithëse kjo parashikohej nga licenca e saj.

Gjithashtu, u zbulua se pacientë që rezultojnë se ishin shtruar me diagnoza që nuk lidheshin me kancerin, gjatë qëndrimit në klinikë kishin marrë barna kimioterapie. Autoritetet po hetojnë nëse në këto raste janë dërguar të dhëna të pasakta në EOPYY, fondin publik grek të sigurimeve shëndetësore, për të marrë rimbursimin e shtrimeve.

Problemet në këtë klinikë nuk ishin të reja. Që në vitin 2025 ishte konstatuar mungesa e personelit. Në fillim të vitit 2026, asaj iu hoq certifikata e funksionimit të rregullt dhe ishte rekomanduar mbyllja përfundimtare. Megjithatë, ajo vazhdoi të punonte. Tani është vendosur heqja e licencës dhe mbyllja e klinikës, ndërsa dosja është dërguar edhe në Prokurori.

Rasti vjen vetëm pak javë pas vdekjes së Giorgos Mazonakis në një qendër private në Athinë, gjatë një procedure plazmaferenze. Vdekja e këngëtarit nxori në pah boshllëqe të mëdha në kontrollin e sektorit privat të shëndetësisë dhe çoi në nisjen e kontrolleve të reja në të gjithë vendin.

Me sistemin e ri MedWatch, autoritetet kanë skanuar mijëra klinika, kabinete, qendra estetike dhe struktura të tjera private. Vetëm në fazën e parë, në Atikë, janë evidentuar 231 struktura të klasifikuara si “të kuqe”, pra me indikacione që kërkojnë kontroll të menjëhershëm, ndërsa 424 të tjera janë futur në kategorinë “e verdhë” dhe do të rikontrollohen. Kjo nuk do të thotë se të gjitha janë të paligjshme, por se kanë paraqitur elementë që duhen verifikuar në terren.

Kryesore



Investigimi i Fiks Fare/ “Nëse Bela çon emrin...”, Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtoreve për “shafen”

20:50

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë

12:58

“Shtatë kandidatë për BE, sa fëmijët e Ursulës”/ Ironia e Ramës: Von der Leyen nuk u tha vajzave “shko me gangsterin rus” apo “luaj me lodrat kineze”

11:06

Puna e bërë duhet t’i njihet Shqipërisë”/ Zytari i lartë i BE, McAllister: Parlamenti Europian do vijojë mbështetjen

12:22

“Kujdes!”/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

10:15

Më të lexuarat

“Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro”, si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltër i prezantua si djali i kreut të FSHF

Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale të mos cenojnë besimin te shteti

FOTOLAJM/ U shfaq për herë të parë në publik, kush është Elvis Lila, drejtuesi i SHISH i komanduar nga Rama

Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

11 fëmijë, 7 gra, 3 Champions, 160 milionë të humbura, jeta e shfrenuar e Roberto Carlos

Mesazhe me përmbajtje seksuale me nxënësen 13-vjeçare, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnjë

“Kujdes!”/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

Mes rasteve që po kontrollohen ka klinika private, poliklinika, kabinete mjekësore, qendra estetike, spa, madje edhe biznese që reklamoni shërbime mjekësore pa pasur të drejtën për t'i kryer ato.

Çështja ka shkaktuar edhe përplasje të fortë politike me partitë opozitare që akuzojnë qeverinë se mekanizmat e kontrollit të klinikave private kanë qenë të pamjaftueshëm dhe se problemet janë lënë për vite pa mbikëqyrje.

Top Channel

"Ne këtu gjejmë arsye shpesh për debat, por biem dakord vetëm për...", Rama mesazhe të qarta BE-së: Nëse lini Shqipërinë në baltë, do jetë dështimi juaj më i madh

Shkarkimi i Vlora Hysenit, mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare i thirrur nga Presidenti Begaj

Sot Konferenca Ndërparlamentare, Rama, Peleshi dhe Schieder të pranishëm. Në fokus zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

I Bota »



"Kjo është beteja e fundit"/ Spotet e Trump ndezin polemika, opozita: Propagandë e paligjshme e paguar nga taksapaguesit

28/09 20:41



Lirohen pesë komplotistët/ U arrestuan se dyshoheshin për sulm ndaj bazës amerikane në Angli, dalin në liri me kusht

28/09 20:37



Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli me gomonen me motorë të fuqishëm

28/09 20:24



Të paktën 13 të vdekur pas spërthimit në një fabrikë fishekzjarrësh në Rusi

28/09 20:13



Tronditëse në Itali/ 53-vjeçari dyshohet se mbyti nënën 85-vjeçare në gjumë pas konflikteve të vazhdueshme

28/09 20:03



Ebola shkakton tensione në Kongo, zyrtari i lartë rihet për vdekje pas emisionit në radio

28/09 19:54

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Lirohen pesë komplotistët, u arrestuan për sulm ndaj bazës amerikane në Angli



Top Channel/ Artistët kërkojnë të ardhurat, debati në Komisionin e Kulturës: Suada nuk funksionon



Top Channel/ Aksidentet u rritën këtë vit, 8-mujori me 983 aksidente, 6.2% më shumë se vjet



Top Channel/ PS rrëzon "hartën" e PD për 100 bashki, nuk u miratua në Kuvend



Top Channel/ Zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë, çfarë thanë drejtuesi i ri i SHISH dhe kreu i SPAK



Top Channel/ Ngacmonte nxënësen 13 vjeçe, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnjë, banorët të tronditur

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli

Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			
© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.					

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.